



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA SHKODËR

Nr. 1598 Prot

Shkodër, më 31.01.2022



OPERA DELLA DIVINA PROVVIDENZA

MADONNINA DEL GRAPPA

Nr. 7 Prot

Shkodër, më 31.01.2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot në Bashkinë Shkodër, me datë ___/___/___, ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

Bashkia Shkodër, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër **Znj. Voltana Ademi**, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar, adresë: Rruga 13 Dhjetori, Nr.1-Shkoder, këtej e tutje e cilësuar si Bashkia.

dhe


Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa, rregjistruar sipas vendimit të gjykatës nr. 132, dt 09.04.1999, me nr. NIPT K46920001A përfaqësuar nga administratori **Z.Fabrizio Nocchi**, identifikuar nga karta identiteti me nr. **YA7322382**, në cilësinë e administratorit, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar, adresa: Rruga Motrat Stigmatine (Gjuhadol)-Shkodër, këtej e tutje e cilësuar si Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa.

Të përgjithshme:

Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa është një shoqatë e themeluar në vitin 1999 sipas vendimit të gjykatës nr.132, dt 09.04.1999, e cila ofron shërbim të përkujdesit rezidencial dhe ditor për persona me aftësi ndryshe, të dalë nga institucionet publike të përkujdesit rezidencial, (Qendra e Zhvillimit) dhe familje në vështirësi socio-ekonomike.

Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa e cila zhvillon aktivitetin në Qarkun Shkodër-**është** liçensuar për Shërbime të Përkujdesit Rezidencial per persona me aftesi ndryshe nga Qendra Kombëtare e Liçensimit Shtetëror, me nr. Liçense LN – 2137-10-2010, (pa afat) me NIPT K46920001A

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al



Ajo është aktive në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1992 e deri më sot dhe ka si objektiv kryesor asistencën social-sanitare për persona me aftësi të kufizuar.

Fillimisht një prej objektivave ka qenë eksperiencia e deinstitutionalizimit, si koncept i ri i mikpritjes i personave të braktisur dhe pa mbështetje familjare, në një ambient tjetër i ndryshëm nga ai i origjinës.

Shoqata “Madonnina del Grappa” përkujdeset për 10 djem të moshave 35-64 vjec dhe 8 vajza të moshës 33-50 vjeç, të gjithë me aftësi të kufizuar intelektuale(te lehte, te moderuar dhe te thelle) dhe me aftësi të kufizuar fizike.

Nevojat e përfituesve janë të ndryshme dhe të shumëllojshme: sociale, ekonomike, shëndetësore, emocionale, etj. Parimi kryesor në ofrimin e shërbimeve bazohet në vlerësimin social e multidisiplinor të nevojave të tyre duke siguruar punën në ekip të personelit.


Vizioni:

Sigurimi i cilësisë, gadishmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve sociale për persona me aftësi të kufizuar duke mbrojtur të drejtat e tyre, si përfitues të drejtpërdrejtë.

Integrimi i 18 personave me aftësi të kufizuar intelektuale dhe fizike, në jetën komunitare, duke e konsideruar nga Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa këtë kategori, si një pjesë e rëndësishme e shoqërisë sonë, e cila meriton dita-ditës përkujdesjen dhe shërbimet e duhura.

Baza ligjore

- Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar;
- Ligjit 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar;
- Ligji nr 137/2020, datë 16. 12. 2020 “Për buxhetin e vitit 2021“, aneksi 4;
- Ligji nr 115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022“, aneksi 4;
- Ligji nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë“;
- VKM nr.717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", të ndryshuar, (lidhja II, klasa VIII për Kujdestarët Social, klasa VI për kuzhinieren, klasa IV për punonjës mirëmbajtje, furnizimi)
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017 "Për Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, Kryeministri, Aparatet e ministrive të linjës, Administratën e Presidentit, Kuvendit, KQZ, Gjykatën e lartë, Prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucione në varësi të Kryeministrit, Institucionet në varësi të Ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", të ndryshuar; **Lidhja I, klasa III b për Titullarin, dhe IV b për Psikologun, punonjës social, fizioterapistin, infermierin dhe ekonomistin.**



- VKM nr.822 date 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale dhe ditore”
- VKM nr. 518, datë 04.9.2018,“Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”
- Udhëzim nr. 689, datë 02.10.2018 ``Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore“
- Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.
- Udhëzimit nr. 30 dt 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar
- VKB Nr. 63, Datë 28.12.2020 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2021 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2021-2023 të Bashkisë Shkodër".
- VKB Nr. 3, Datë 05.01.2022 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër".

NENI 1 Objekti


Objekt i kësaj marrëveshje bashkëpunimi është ofrimi i shërbimeve cilësore për personat me aftësi ndryshe pranë qendrës Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa, sipas standarteve të miratuara, planifikimi i fondit dhe përgatitja e procedurave për lëvrimin e financimeve për pagat dhe siguracionet e personelit, të kuotës ushqimore për përfituesit që përfitojnë shërbime pranë organizatës Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa si dhe shpenzime operative.

Zbatimi i standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, rritja e cilësisë së shërbimeve për persona me aftësi të kufizuar, në situata disavantazhi për çdo lloj arsyeje, qoftë e krijuar ose shkaktuar.

NENI 2 Qëllimi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë së Shkodrës dhe Opera Divina Prov. Madonnina d.Grappa në zbatimin e programit të bashkëpunimit me qëllim ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi ndryshe sipas standarteve të përcaktuara me ligj.

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al



NENI III



Afati i marrëveshjes së bashkëpunimit

Efektet financiare të kësaj marrëveshje bashkëpunimi do të jenë nga 01/01/2022 , deri më 31/12/2022.

NENI 4

Rolet dhe përgjegjësitë e Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa

- Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa administron 1 shtëpi-familje (Shtëpia-familje“Facibeni“) ofron shërbim për përfituesit e shërbimeve në përputhje me standartet sipas VKM nr. 822, datë 06.12.2006, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale dhe ditore”.
- Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa duhet të paraqesë pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik të Bashkisë së Shkodrës çdo muaj një raport narrativ mbi ecurinë e shërbimit të ofruar për përfituesit (të dhëna mbi numrin e përfituesve, shërbimet e ofruara, problematika të veçanta për periudhën e raportimit, aktivitetet e zhvilluara gjatë muajit, aspekte të veçanta, etj.)
- Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa bashkëpunon me Bashkinë Shkodër për sistemimin e personave me aftësi të kufizuar, që janë banorë të Bashkisë Shkodër. Për çdo ndryshim që mund të ndodhë përsa i përket numrit të përfituesve (kthim në familje, transferime, vdekje, etj.) si edhe numrit të personelit shërbyes, Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa duhet të informojë në rrugë zyrtare Bashkinë Shkodër.
- Për lëvrimin e fondit të vënë në dispozicion në buxhetin e Bashkisë së Shkodrës, Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa çdo fillim muaji duhet të paraqesë pranë Bashkisë së Shkodrës dokumentacionin si më poshtë:
 - Kërkesë për transferim fondi të detajuar;
 - Bordero të punonjësve në paga bruto dhe neto;
 - Bordero të sigurimeve të gatshme për deklarin e Sigurimeve Shoqërore dhe TAP në Degën e Tatimeve;
 - Relacionin narrativ mbi ofrimin e shërbimeve dhe aktiviteteve të muajit paraardhës;
 - Në momentin e pagesës së muajit që vjen pas, duhet të paraqiten edhe urdhër xhirimet që vërtetojnë pagesat e bëra për muajin paraardhës;
 - Listë të përfituesve për muajin për të cilin do bëhet pagesa.
- Për lëvrimin e fondit të vënë në dispozicion në buxhetin e Bashkisë së Shkodrës, Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa për kuotën ushqimore të përcaktuar sipas udhëzimit Nr. 689 datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”,



Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa, duhet të sjellë dokumentacionin sipas procedurës ligjore të menaxhimit të fondeve publike.

- Çdo fillim muaji paguhen pagat e muajit paraardhës.
- Çdo fillim muaji paguhen faturat e energjisë elektrike të çdo muaji.
- Çdo fillim muaji paguhen faturat e ujësjellësit të çdo muaji.
- Çdo fillim muaji paguhen faturat e telefonit të çdo muaji.
- Në rastet e blerjes së materialeve të ndryshme, kryerjes së shërbimeve, për likuidimin e tyre, Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa duhet të sjellë dokumentacionin sipas procedurës ligjore të menaxhimit të fondeve publike.

NENI 5

Rolet dhe përgjegjësitë e Bashkisë Shkodër


Bashkia e Shkodrës, në buxhetin e bashkisë për vitin 2022 të miratuar me VKB Nr. 3, Datë 05.01.2022 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër", Programin 10430: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët, projektin: P10430.O7.A3 "Shtëpi familje për persona me aftësi të kufizuar nga Opera Madonnina del Grappa", si një domosdoshmëri për mbështetje në ofrimin e shërbimeve alternative për personat me aftësi ndryshe, pa përkujdes dhe interesim familjar dhe me problematika të ndryshme, me qëllimin kryesor që këto shërbime të ofrohen sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi ndryshe dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike.

- Fondi i parashikuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi me Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa është **16,705,992** lekë ku **16,600,000** lekë nga buxheti i vitit 2022 dhe **105,692** lekë nga tepricat nga fondi i vitit 2021 që do të përdoren në vitin 2022 për energjinë elektrike.

○ Paga dhe sigurime	12 554 040 lekë
○ Kuota ushqimore	3 285 300 lekë
○ Energji Elektrike	621 652 lekë
○ Ujësjellës	60 000 lekë
○ Telefon	45 000 lekë
○ Ilaçe	100 000 lekë
○ Gaz	40 000 lekë

- Pagat e punonjësve mbështetës të Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa janë të llogaritura sipas VKM nr.717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", të ndryshuar, (lidhja II, klasa VIII për Kujdestarët Social).
- Pagat për Titullarin, Psikolog, Ekonomist, Punonjës social, Fizioterapist dhe Infermierin janë të llogaritura sipas VKM nr 187 ,datë 08.03.2017 "Për Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve,

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al



zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, Kryeministri, Aparatet e ministrive të linjës, Administratën e Presidentit, Kuvendit, KQZ, Gjykatën e lartë, Prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucione në varësi të Kryeministrit, Institucionet në varësi të Ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, **Lidhja I, klasa III b për Titullarin, dhe IV b** për Psikologun, punonjësin social, ekonomistin , fizioterapistin dhe infermierin.

- Kuota ushqimore e parashikuar për personat që jetojnë në shtëpi-familje të Madonnina , është e llogaritur sipas Nr. 689 datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”, kuota ushqimore për personat e vendosur në qendrat e zhvillimit të moshës mbi 18 vjeç është 500 lekë në ditë (365 ditë x 18 persona x 500 lekë/ditë = 3 285 300 lekë/vit).
- Bashkia Shkodër, pasi Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa sjell dokumentacionin e përcaktuar në nenin IV të kësaj marrëveshje bashkepunimi, përgatit relacionin dhe shkresën përcjellëse për lëvrimin e fondit, për drejtorinë e financës.
- Bashkia Shkodër monitoron dhe vlerëson ofrimin e shërbimeve të ofruara nga Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa.
- Bashkia Shkodër bashkëpunon me shoqatën Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa për sistemimin e personave me aftësi të kufizuar, që janë banorë të Bashkisë Shkodër.
- Bashkia Shkodër, çdo fillim muaji paguan pagat e muajit paraardhës.
- Efektet financiare për këtë marrëveshje bashkëpunimi do të jenë sipas kohëzgjatjes së kësaj marrëveshje bashkëpunimi, përcaktuar në nenin III të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi.

NENI 6

Mënyra e lëvrimit të fondit

Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Shkodër, brenda datës 10 të çdo muaji do të bëjë transferimin e vlerës mujore, nga fondi i miratuar, në llogari të Opera Divina Prov. Madonnina d. Grappa në numrin e llogarisë 34345531802, IBAN AL 22208511830000034345531802, në bankën INTESA SAN PAOLO BANK- dega Shkodër.

NENI 7

Dispozita të fundit

- Kjo Marrëveshje bashkëpunimi hartohet në katër kopje të barazvlefshme.
- Në rast të zvogëlimit të numrit të punonjësve, fondi do të zvogëlohet në raport me numrin e punonjësve.
- Palët pasi e lexuan marrëveshjen, me vullnetin e tyre të lirë e nënshkruan atë.



- Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve, në rast të kundërt për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët mund t'i drejtohen Gjykatës kompetente.

PËR
BASHKINË SHKODËR

PËR
OPERA DIVINA PROV. MADONNINA
D. GRAPPA

KRYETAR

Voltana Ademi



ADMINISTRATOR

Fabrizio Nocchi

